

16.06.2022
Nr-Prot. 02/246

REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E SHTIMES/OPSTINA STIMLJE

Nr i Prot./Br Prot 02 / 246

Nr i Faqevel/Br.strana _____

Data/Dana/ 16/06/2022

SHTIME/ŠTIMLJE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
ZYRA E KRYEMINISTRIT - UREDI PREMTERIA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER
SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR

Nr. Ori. /
Cl. orig./
Orig. nit 01

Nr. Prot.
Br. Prot.
Prot. No. 11/09/13

Nr. Drove
Br. Drove/
Drove No. -PO-

Data/
Datum/
Date: 13.06.2022

Prishtinë/a

Karta për Komunën e gjelbër dhe të qëndrueshme
2022 - 2030

Prishtinë, 31 maj 2022

Karta për Komunën e gjelbër dhe të qëndrueshme është iniciativë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila ka për qëllim që të përshpejtoj realizimin e **Marrëveshjes së Gjelbër për Kosovën** dhe të përmbush **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm** deri në vitin 2030.

Përmes kësaj marrëveshje Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Komuna e Shtimes ndajnë vizionin e njëjtë për transformimin e komunës në një vend:

- më të pastër, më të zhvilluar dhe më të qëndrueshëm;
- më tërheqës për të jetuar, punuar dhe investuar;
- që kujdeset për shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve.

Qeveria dhe Komuna e Shtimes zotohen për bashkërendim të politikave, projekteve dhe aktiviteteve dhe bien dakord që të punojnë drejtë transformimit të komunës në komunë të gjelbër dhe të qëndrueshme;

Komuna zotohet se do të angazhohet aktivisht për të trajtuar sfidat më urgjente mjedisore për të nxitur një tranzicion të drejtë ekologjik;

Komuna është e përkushtuar që me punë dhe angazhim të përbashkët me nivelin qendror të avancoj zbatimin e Agjendës së Gjelbër dhe të arrij sukses në përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm;

Komuna e mirëpret Kartën dhe zotohet për zbatim të plotë të saj.

Komuna zotohet që të ndërmarr veprime në pesë fushat e Agjendës së Gjelbër:

Zotimi për klimën

Gradualisht të ndryshojmë mënyrën se si i ngrohim ndërtesat publike dhe private në dimër dhe si i ftohim ato gjatë verës, duke investuar në izolim përmes modernizimit të tyre;

Zhvillimin e projekteve për ndërtimin dhe zgjerimin e sistemeve të rinovushme të ngrohjes qendrore;

Transformimin gradual të sistemeve të mobilitetit përmes investimeve në infrastrukturë të qëndrueshme dhe zhvillimin e skemave multimodale, duke filluar nga shërbimet e transportit publik urban dhe mjetet tjera me shkallë të ulët të ndotjes, korsitë e biçikletave dhe zona të sigurta për këmbësor.

Zotimi për prodhimin e qëndrueshëm dhe përdorimin efiçient të burimeve

Zhvillimin e strategjive lokale dhe planeve të veprimit të ekonomisë qarkore ndër sektoriale, e cila integron qasjet ekonomike dhe mjedisore, si një mundësi e jashtëzakonshme për të forcuar ekonominë lokale;

Vendosjen e objektivave të riciklimit duke përfshirë edhe përgjegjësinë e prodhuesit në projektimin e produktit;

Krijimin e qendrave të riciklimit, ndarjen e mbeturinave dhe trajtimin e tyre;

Përmirësimin e menaxhimit të ujërave të ndotura dhe shqyrtimin e mundësive drejt fillimit të ripërdorimit të tyre;

Inkurajimin dhe mbështetjen e bizneseve lokale për të kaluar nga modeli linear i prodhimit në një model biznesi qarkor;

Zhvillimin e programeve për reduktimin e mbetjeve ushqimore;

Zhvillimin e programeve për mbështetje të zhvillimit të teknologjive të reja;

Zhvillimin e turizmit.

Zotimi për mbrojtjen e biodiversitetit

Zhvillimin dhe zbatimin e Planeve të Veprimit për Biodiversitetin dhe mbrojtjen e natyrës;

Përgatitjen dhe zbatimin e planeve për restaurimin e peisazhit lokal;

Forcimin e mekanizmave për ruajtjen e biodiversitetit;

Mbrojtjen dhe menaxhimin e pyjeve;

Mbrojtjen e parqeve ekzistuese dhe krijimin e parqeve të reja në zonat urbane.

Zotimi për ajër, ujë dhe tokë të pastër

- Identifikimin e burimeve të ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës dhe caktimin e zonave me ndotje më të lartë;
- Zhvillimin e programeve për të trajtuar burimet kryesore të ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës;
- Zbatimin e politikave dhe rregulloreve për të arritur rezultate konkrete në reduktimin e ndotësve të ajrit, ujit dhe tokës;
- Krijimin e zonave urbane me ndotje të ulët ose zero duke kufizuar qarkullimin e automjeteve dhe transferuar ato zona në zona publike për këmbësorët dhe çiklistët;
- Promovimin e ecjes, çiklizmit dhe përdorimit të transportit publik;
- Investime në infrastrukturën për monitorimin e cilësisë së ajrit;
- Zhvillimin e programeve në bashkëpunim me nivelin qendror dhe institucionet tjera përgjegjëse në monitorimin e ujërave, sipërfaqësor, nëntokësor dhe ujërave të zeza urbane;
- Investime në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura dhe teknologji tjera për reduktimin e ndotjes;
- Projekte në uljen e ndotjes akustike e cila shkakton problem shëndetësor te popullata urbane;
- Identifikimin dhe mbrojtjen e zonave të qeta nga rritja e niveleve të zhurmës, menaxhimin e trafikut dhe uljen e shpejtësisë së mjeteve motorike në zonat e banueshme.

Zotimi për bujqësi dhe sistem ushqimor të qëndrueshëm

- Hartimin e strategjive për zhvillimin e bujqësisë përmes parimeve të ekonomisë qarkore;
- Programe për nxitjen e zhvillimit të bujqësisë ekologjike përmes riorientimit të subvencioneve bujqësore;
- Programe për dekarbonizmin e sektorit të bujqësisë duke ndryshuar mënyrën e prodhimit dhe të tregtimit të produkteve bujqësore;
- Zvogëlimin e përdorimit të kimikateve, përmes mbështetjes financiare, edukimit dhe trajnimeve, që mbetjet organike të shndërrohen në plehra organik ose biogas;
- Mbështetja e prodhuesve dhe përpunuesve të sektorit agro-ushqimor për të lehtësuar transferimin në teknologji inovative dhe miqësore me mjedisin.

Përmes nënshkrimit të Kartës Qeveria zotohet që të ndihmoj Komunën në:

- Mbledhjen e të dhënave dhe analizën e gjendjes aktuale;
- Identifikimin e ndotësve, zonat specifike dhe nivelin e ndotjes;
- Sasinë e mbeturinave përfshirë këtu edhe mbetjet nga ushqimi;
- Listimin e burimeve natyrore dhe zonave që duhet mbrojtur;
- Përcaktimin e objektivave, masat dhe planin e veprimit që do të ndërmer Komuna për të përshpejtuar realizimin e Agjendës së Gjellbër;
- Të ofroj ndihmë teknike dhe financiare për të mbështetur projektet që kanë për qëllim realizimin e objektivave të Agjendës së Gjellbër;
- Të ndihmoj Komunitat të zhvilloj politikat në përputhje me sfidat mjedisore urbane;
- Të mbështet dhe nxisë inovacionin lokal;
- Çdo projekt që financon Qeveria duhet të jetë në përputhje me 5 shtyllat e Agjendës së Gjellbër.

Përmes nënshkrimit të Kartës, Komuna do të përfitoj:

- Mbështetje financiare e profesionale në dizajnimin e politikave të integruara të zhvillimit urban social dhe ekologjik;
- Mbështetje financiare për realizimin e projekteve;
- Mbështetje që të bëhen pjesë e rrjeteve dhe iniciativave evropiane dhe globale të qyteteve;
- Promovim dhe njohje për veprimet dhe arritjet mjedisore të Komunës;
- Bëhen pjesë e tranzicionit drejt një Kosove të gjellbër, të shëndetshme dhe të qëndrueshme;
- Qasje në informacione rreth thirrjeve lokale dhe ndërkombëtare për mbështetje financiare;

Komuna obligohet të raportoj për:

- Progresin e arritur në realizimin e objektivave që do të vendos për të përshpejtuar realizimin e Agjendës së Gjellbër deri në vitin 2030;
- Raportimi bëhet çdo vit përmes platformës digjitale;
- Obligohet të bëjë ngritjen e kapaciteteve njerëzore për zbatimin e Agjendës së Gjellbër në nivel lokal;

Kryetari i Komunës

Qemajl Aliu

Kryeministri i Qeverisë

Albin Kurti